



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:165123
Datë: 29.08.2022
Numri i dokumentit: 03369181

PKR.nr.147/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, sipas Kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit R.K, për veprë penale *Ushtrim ndikimi nga neni 424 par.1 të KPRK-së*, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP/I.nr.207/20222, të datës 12.08.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar në prezencë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av.Gëzim Kollçaku, pa prezencën e Prokurorit të Shtetit Agron Galani, me datë 22.08.2022, në të njëjtën ditë bie dhe shpall, ndërsa me datë 29.08.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **R.K** i biri i S dhe i nënës H, e gjinisë S, i lindur ... në N, Republika e M të Z, me vendbanim në fshatin V, Komuna e P, rr. J M, pa numër, ka të kryer shkollën e lartë të komunikacionit, zyrtar policor në Stacionin Policor, Nënstacioni Policor në fshatin G, Komuna e Pejës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal lëshuar nga MPB të R. Kosovës, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Gjatë muajit qershor dhe korrik 2022 në Pejë, si Instruktor i vozitjes në Auto Shkollën “F. T” në P, të cilën veprimtari e ushtronte si veprimtari sekondare jashtë detyrës zyrtare, pas përfundimit të orarit të rregullt të punës si polic, me dashje dhe me vetëdije të plotë në mënyrë të drejtpërdrejte e me qëllim të përfitimit material për veti, apo edhe për personin tjetër, pasi që më parë i pandehuri në cilësi të personit zyrtar, polic në Nënstacionin Policor në fshatin G., Komuna e P, ka ndaluar dhe gjobitur të dëmtuarin – dëshmitarin M. disa herë për shkak të ngasjes së veturës pa patentë shofer, në gjendje të dehur dhe keqpërdorim të targave, kërkon nga i dëmtuari M.shumën prej 800 € duke i thënë se t’i me ardhë tek unë,

me e marrë patentë shoferin dhe se do ta pajisë me patentë shofer jashtë procedurave ligjore, do ta sigurojë dhënien e provimit teorik dhe praktik për kategorinë B, duke i thënë se ai është në gjendje që të ushtojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar dhe duke kërkuar që të caktojë një takim lidhur me pranimin e parave dhe pasi i dëmtuari – dëshmitari me datë 25.07.2022 e njofton IPK-në dhe pas disa bisedave telefonike mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, i pandehuri R.dhe i dëmtuari-dëshmitari M.me datë 30.07.2022 takohen në lokalim – O në hapësirat e I-it në Pejë, ku e priste M., me ç’rast pas një bisede të shkurtër i dëmtuari-dëshmitari M.i dorëzon të pandehurit R.shumën prej 800€, dhe pasi i pandehuri ato para i futë në çantën e krahut, arrestohet nga hetuesit e IPK-së,

-Me çka ka kryer vepër penale *Ushtrim ndikimi nga neni 424 par.1 të KPRK-së.*

Andaj në aplikim të dispozitave të nenit 7, 17, 38, 39 par.1 pika 1.1, 40 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 42, 43, 44 par.1, 69, 70 par.3 pika 3.10, 3.11, 71 par.1 pika 1.2, 72 par.1 pika 1.5, 76 par.1, nenit 424 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 365, 366, 453 par.3 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) €.

Në kuptim të nenit 44 par.1 dhe 2 të KPRK-së:

Me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar prej gjashtë (6) muaj burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej tetëmijë (8.000) € ashtu që, të njëjtit:

Në aplikim të nenit 76 par.2 nënpar.2.4 lidhur me par.1 të KPPRK-së i shqiptohet:

DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej **dhjetëmijë (10.000,00)€**, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 30.07.2022 gjerë me datë 22.08.2022, shumë të cilën është i obliguar ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në tërësi, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 € gjobë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i pandehuri, që në emër shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën me nga pesëdhjetë (50)€, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i pandehuri që taksa shtesë në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguajnë shumën me nga pesëdhjetë (50) €, të gjitha në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari M.B., nga fshati P., Komuna e P, për realizmin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

REFUZOHET propozimi i PTHDKR që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënimi plotësues–ndalim i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik, meqenëse nuk janë përmbushur kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 59 par.2 pika 2.3 lidhur me nenin 62 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

A r s y e t i m

Historiku i rastit.

Me datë 12.08.2022, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/I.nr.207/20222, kundër të pandehurit R.K, për veprë penale *Ushtrim ndikimi nga neni 424 par.1 të KPRK-së*

Lënda në punë është pranuar me datë 15.08.2022.

Me datë 22.08.2022, është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë, bazuar në dispozitën e nenit 244 të KPPRK-së, është konstatuar se Prokurori i Shtetit, i ka përmbushur detyrimet dhe mund të vazhdohet me mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, Kryetarja e trupit gjykues, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e udhëzuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konform dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga askush.

Kryetarja e trupit gjykues ka marrë mendimin nga mbrojtësi i të pandehurit dhe prokurori i shtetit, të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasur parasysh se

pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dhe ka mbështetje në provat të cilat i janë bashkangjitur aktit akuzues.

Kryetarja e trupit gjykues, ka aprovuar pranimin e fajësisë e bindur se pranimi i fajësisë është bërë në përmbushje të kushteve ligjore të nenit 248 par.1 pika 1.1 deri 1.4 të KPPRK-së, i cili pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës siç janë: vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve-dy telefonave nga i dyshuari R.K datë 30.07.2022 nën nr..../.../.../..., vendimi për punësim jashtë detyrës zyrtare për të pandehurin R.K i datës 04.04.2016, dt.08.05.2019 dhe dt.14.10.2021, kontratës të punës me orar të shkurtuar për kohë të pacaktuar dt.01.02.2019 lidhur mes të pandehurit R.dhe Auto Shkollës “F. T”, licencës për Instruktor – shofer nën nr. ... të lëshuar nga M.I.T për të pandehurin R.K.datë 04.03.2019 valide deri me datë 03.03.2024, fotove të parave të sekuestruara nga i pandehuri R në shumë prej 800 €, një DVD (video dhe audio incizim) nga vendi i ngjarjes me nr. ... me kapacitet 546 MB, minuta e video incizimit 04:25 (koha reale 18,58,42), fotografit e parave në shumë prej 800€ të siguruar nga fondi i IPK-së, e të përdorura në këtë rast, E-mailit zyrtar të IPK-së –Departamenti i Hetimeve dt.02.08.2022 lidhur me paratë e përdorura në simulimin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit, dhe nuk ka gjetur arsyeje për hedhje të aktakuzës, meqë nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike siç është përcaktuar në dispozitën e nenit 248 par.1 pika 1.4 të KPPRK-së.

Në bazë të pranimit të plotë të fajësisë të të pandehurit R.K, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës të cituara më lartë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale *Ushtrim ndikimi nga neni 424 par.1 të KPRK-së*

Konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar me seancën për caktim të dënimit.

Prokurori i Shtetit, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka propozuar gjykatës, që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, derisa si rrethanë rënduese se i njëjti ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë kryen vepër penale, rrethanë e cila ndikon në humbje të besimit të qytetarëve. Poashtu ka propozuar që ndaj të njëjtit përveç dënimit kryesor, konform nenit 59 par.1, pika 2.3 të KPRK-së, t'i shqiptohet ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose në shërbimin publik.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Gëzim Kollqaku, R.K, i ka propozuar gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merret parasysh pranimi i fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, derisa si rrethana tjera lehtësuese gjykata të ketë parasysh keqardhja për veprimet e tij, pendimin e thellë të shfaqur publikisht, të kaluarën e tij e pastër kriminale dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, ka propozuar që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa me i butë.

I pandehuri R.K, e ka mbështetur në tërësi mbrojtësin e tij, duke shtuar se ndihet mjaft i penduar dhe se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin.

Me rastin e vendosjes së dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 i KPRK-së, që ndikojnë që dënimi të jetë më i ulët ose më i lartë, ashtu që si rrethanë lehtësuese mori faktin se ishte i sinqertë lidhur me pendimin për veprimet e ndërmarra në kundërshtim me ligjin, si dhe të kaluarën e tij të pastër kriminale.

Ndërsa si rrethana veçanërisht lehtësuese, bazuar në dispozitën ligjore të paraparë nenin 70 par.3 pika 3.10 dhe 3.11 të KPRK-së, mori pranimin e fajësisë dhe keqardhjen e shfaqur publikisht, andaj gjykata marrë për bazë të gjitha këto rrethana të pandehurit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë bazuar në nenin 72 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, për veprat penale për të cilat parashihet minimumi i përgjithshëm i dënimit prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim, në rastin konkret i pandehuri ka kryer vepër penale për të cilën parashihet dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Ndërsa si rrethanë rënduese konform nenit 70 par.2 lidhur me par.1, pika 2.2 të KPRK-së, gjykata mori shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, mirëpo në raport me rrethanat lehtësuese gjykata erdhi në përfundim se të njëjtat mbizotërojnë në raport me këtë rrethanë, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke pasur parasysh rrethanat lehtësues dhe rënduese, gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat për peshën e krimit dhe shkallën e fajit të të pandehurit, dhe se do të ndikoj mjaftueshëm që i njëjti të mos kryej krime në të ardhmen dhe në të njëjtën kohë të parandalojnë autorët e mundshëm të këtyre krimeve, në aspektin e parandalimit të tyre dhe se do të arrijë plotësisht qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Sa i përket propozimit të prokurorisë, që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënimi plotësues-ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, gjykata erdhi në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e këtij dënimi, pas parasysh se dispozita e nenit 62 të KPRK-së, si kriter për shqiptimin e këtij dënimi parasheh se personi duhet të ketë cilësinë e personit zyrtar, në rastin konkret i pandehuri K., është akuzuar se ka kryer veprën penale në cilësi të instruktorit, dhe jo të policit, andaj referuar kësaj gjendje, pas parasysh dhe faktin se vepra penale nga neni 424 par.1 të KPRK-së, mund të kryhet nga çdo person, gjykata ka refuzuar propozimin e prokurorisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 453 par.1, lidhur me nenin 450 par.2 pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për llogaritje të paraburgimit në dënim, është marrë në aplikim të nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marrë konform nenit 463 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.147/22

Bashkëpunëtore profesionale
Elzana Kastrati

Kryetarja e trupit gjykues
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.